



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1326/2 Prot.

Tiranë, më 15 / 10 / 2018

V E N D I M

Nr. 198, Datë 15 / 10 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 155, datë 01.10.2018, të paraqitur nga shtetasi L.M kundër IEVP Peqin në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes arsimore”, “gjendjes familjare” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga L.M, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se, që prej datës 10.03.2018 kur është transferuar në IEVP Peqin është përballur me diskriminim nga stafi policor dhe më pas dhe nga Shefi i Sektorit të Edukimit duke nxitur urrejtjen tek të dënuarit e tjerë në mënyrë që këto të fundit të grindeshin me të. Në datë 27.08.2018 i është rrezikuar jeta nga i dënuari M.K i cili ka ushtruar dhunë ndaj tij dhe Shefi i Rregjimit të Brendshëm dhe polici i shërbimit A.K nuk kanë marrë asnjë masë për të parandaluar ngjarjen apo për të informuar eprorët për ankesat e shtetasit L.M. Nga dhuna e ushtruar nga i dënuari M.K në datë 27.08.2018 është shtruar fillimisht në Spitalin e Peqinit pastaj për mjekim më të kualifikuar në Spitalin Rajonal të Elbasanit dhe më vonë në Spitalin e Burgut në Tiranë. Në datë 07.09.2018 është kthyer përsëri në IEVP Peqin.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, marrjen e masave administrative për mbrojtjen e tij nga diskriminimi ose për transferimin e tij në një institucion tjetër.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Ankuesi në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me konfliktin dhe problematikën që ka patur për ushtrim dhune nga të dënuarit e tjerë, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se mosmarrja e masave nga ana e personelit të I EVP Peqin është bërë për shkak të “gjendjes ekonomike, arsimore, familjare” apo cilësive të veçanta që ankuesi ka.

Në referim të të dhënave të paraqitura nga subjekti ankues vërehet se pretendimet e tij janë bazuar në denoncimin e veprimeve të dhunshme nga ana e të dënuarve të tjerë dhe mosmarrjen e masave parandaluese nga ana e autoriteteve drejtuese të I EVP Peqin, dhe jo si pretendime për trajtim të pabarabartë në raport me të dënuarit e tjerë.

Referuar për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e jashtëligjshme të personave që ushtrojnë funksione publike parashikohen si vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe pala ka të drejtë ti denoncojë këto veprime pranë organeve kompetente.

Gjithashtu, ligji nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në nenin 31/1, parashikon që: *“Avokati i Popullit ushtron funksionet e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi. Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues organizohet dhe funksionon si seksion i veçantë i Avokatit të Popullit”.*

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, shtetasi L.M mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të personelit të IEVP Peqin, por në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkaqeve të pretenduara nga ankuesi, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rekomandon ankuesin që t'i drejtohet institucionit të Avokatit të Popullit, si një organ i cili ka në funksion të detyrës së tij trajtimin e rasteve në fjalë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/b dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit L.M, për shkak se nuk është e pajtueshme me dispozitat e ligjit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONERI